



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0906

OSHP: 2023/0908

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP), në përbërje Vedat Poterqoi -Kryetar, Vjosa Gradinaj-Mexhuani dhe Isa Hasani Anëtar, duke vendosur lidhur me ankesat e Operatoreve Ekonomik (OE) “N.P.T” Haxhijaha” SH.P.K.” dhe “Vibtis” ushtruar kundër vendimit për dhënie e kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimimepajisjepërpastriminekryeqytetit” numërprokurimi "616-23-7016-1-1-1”iniciuar nga Komuna e Prishtinës në cilësinë e autoritetit kontraktues (AK), me 25.01.2024, mori,

Vendim

1. Aprovohen si pjesërisht të bazuara ankesat e OE “Vibtis” Dega në Kosovë me nr. 2023/0908, e datës 16/11/2023, dhe ankesa e OE N. P.T "Haxhijaha" Sh.P.K. me nr. 2023/0906, e datës 14/11/2023, kurse vendimi i AK Komuna e Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me pajisje për pastrimin e Kryeqytetit” me numër të prokurimit 616-23-7016-1-1-1 anulohet dhe lënda kthehet në **rivlerësim**.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

3. Meqenëse ankesat aprovohen si pjesërisht të bazuara, u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 14.11.2023, OE "NTP Haxhijaha" ka ushtruar ankesë [Protokolli: 0906/2023] me të cilën ka atakuar Vendimin e autoritetit kontraktues të datës 27.10.2023 sipas të cilit Grupi i Operatoreve Ekonomik (GOE) "D&T Group" SH.P.K; Kosova Motors" J.S.C. "Furnizimi me pajisje për pastrimin e kryeqytetit" i cili evidentohet me numër prokurimi "616-23-7016-1-1-1".

Me 16.11.2023, po ashtu edhe OE "VIBTIS" Dega në Kosovë" ka ushtruar ankesë [Protokolli: 2023/0908]

Aktiviteti i prokurimit i përshkruar si më sipër, është iniciuar nga Komuna e Prishtinës në cilësinë e cila ka zbatuar në këtë rast procedurë të hapur sikurse parashihet me nenin 4 (paragrafi 1.36) lidhur me nenin 32 dhe 33, lloji i kontratës furnizim sikurse parashihet me dispozitën e nenit 19 dhe me vlerë të madhe, sikurse parashihet kjo me nenin 4 (paragrafi 1,28) lidhur me nenin 19, paragrafi 1, të LPP.

Në fazën e shqyrtimit paraprak,

OSHP ka konstatuar se ankesat në rastin konkret janë ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar ka të drejtë të parashtrojë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake, sikurse kërkohet në kuptim të nenit 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesit kanë statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesat i përmbajnë elementet në kuptim të nenit 111, të Ligjit të cituar, të njëjtat bijën nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP. Bazuar në veprimet si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe po ashtu ka angazhuar ekspertet shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që të bëhet shqyrtimin fillestar i dosjes dhe pretendimeve ankimore, sikurse kërkohet kjo sipas nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë:

Me 04.12.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit lidhur me ankesën e rekomandimet si në vijim:

Ankesa të aprovohet si pjesërisht e bazuar;

Të mbetet në fuqi vendimi i atakuar AK;

Kurse me 01.12.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit lidhur me ankesën e OE "VIBTIS" - Dega në Kosovë [Protokolli: 2023/0908], rekomandimet si në vijim:

Ankesa të aprovohet si e bazuar;

Të anulohet vendimi i atakuar i AK;

Lënda të kthehet në rivlerësim;

Paneli konstatoi paraprakisht se Raportet e ekspertizës i përmbajnë elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe të njëjti janë pranuar nga palët, konform nenit 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë:

OE "NTP Haxhijaha" nuk është pajtuar me raportin e cituar, ndërsa AK është pajtuar.

Kurse OE "VIBTIS" është pajtuar me raportin e cituar, ndërsa AK nuk është pajtuar.

Njëherësh konstatohet se palët janë të informuara lidhur me shkresat në përbërjet komplete të këtyre lëndëve sikurse kërkohet me paragrafin 2, të nenit 20 të kësaj Rregulloreje, prandaj janë krijuar kushtet procedurale që Paneli të vendosi në mënyrë meritore përkitazi me ankesën.

Duke ju referuar në këtë rast ankesave të parashtruara, përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në raport me aktivitetin e prokurimit dhe aktin e atakuar të AK, konstatohet paraprakisht se lidhur me çështjen në rastin konkret, gjen zbatim aplikimi i nenit 84 (Bashkimi i çështjeve administrative në një procedure) i Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, lidhur me nenin 16 (Rastet e unifikuara) të Rregullores për Punën e OSHP, sipas të cilit Kryetari i OSHP ka të drejtë të vendos që ti bashkoj rastet/ankesat të cilat në kuptimin e pretendimeve ankimore janë të lidhura me lëndën apo tenderin e njëjtë, mund të përfshihen në raportin e shqyrtimit fillestar nga i njëjti ekspert dhe përkitazi me to ka të drejtë të vendos i njëjti Panel shqyrtues.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Paneli konstatoi senuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, andaj analizoi në vijim të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të caktohet seanca publike me palë, meqë shkresat e kësaj lënde përmbajnë prova të mjaftueshme lidhur me shqyrtimin dhe vendosjen meritore sipas nenit 24.1, të Rregullores së cituar. Në këtë rast pretendimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe shpjegimet e ekspertit shqyrtues, krahas administrimit të gjithmbarshëm të provave janë prezantuar dhe përmbledhur përkitazi me çështjet kryesore, sikurse në vijim të këtij arsytimi.

Ankuesi OE "N.P.T." Haxhijaha" SH.P.K

Ankuesi ka pohuar se shkeljet e autoritetit kontraktues i referohen dispozitave ligjore në kuptim të nenit 1 [Qëllimi], nenit 59 [vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve] dhe nenit 60 [Kriteret për dhënien e kontratës] duke pohuar në fillim se oferta e GOE të rekomanduar për kontratë nuk është dorëzuar nga personi i autorizuar. Lidhur me këtë sipas ekspertit shqyrtues vërehet se pjesë përbërëse e ofertës së GOE të rekomanduar është edhe autorizimi i noterizuar me 11.02.2017, me shifrën e legalizimit LRP5095/2017, sipas të cilit i autorizuari është i pajisur me të drejtën e përfaqësimit, që në emër dhe drejtorit të entitetit afarist "Kosova Motors" JSC, t'i ndërmarr te gjitha veprimet enevojshme përcilëndopune, përfshirë shitjen, lidhjen e kontratave dorëzimin dhe negociimin e ofertave. Duke i analizuar pohimet ankimore nga ky aspekt, Paneli konsideron se eksperti

shqyrtues ka të drejtë në konstatimet e tij, kurse autorizimi nuk karakterizohet me ndonjë të metë, i/e cila do ti mohonte efektet juridike të tij dhe i njëjti është dhënë nga titullari i një të drejtë, sipas të cilit i autorizuari ka të drejtë zbatojë një aktivitet, projekt apo të kryej veprime të caktuar, në pajtim me kushtet e përshkruara sikurse parashihet mes tjerash dhe me nenin 17 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.

Më tej, ankuesi ka pohuar se në kuptim të pikës 9.1 & 9.2 (paragrafi 4) të dosjes së tenderit (DT), kërkohet që OE të dorëzojë një autorizim apo konfirmim të prodhuesit të superstrukturës, i cili duhet të përmbajë shërbimet e dizajnit, zhvillimit, prodhimit, shitjes si dhe shërbimet pas shitjes të automjeteve dhe pajisjeve, ka paraqitur autorizim nga prodhuesi me të cilën autorizohet vetëm për ofertë, negociim, dhënie të ofertës por jo për shërbime pas shitjes së tyre. Paneli vëren se pretendimet e ankuesit nga ky aspekt janë analizuar në mënyrë të detajuar nga eksperti shqyrtues i cili ka shpjeguar se GOE të rekomanduar për dhënie të kontratës e ka prezantuar autorizimin e prodhuesit në deklaratën e të cilit konfirmohet se përmbush të gjitha specifikat teknike të paraqitura në dosjen e tenderit, autorizimeve tjera, ndaras për ofertën e produktit, sistem të superstrukturës dhe garancinë Krahas kësaj GOE të rekomanduar për dhënie të kontratës ka paraqitur dhe katalogët e prodhuesit ku janë përcaktuar po ashtu shërbimet e dizajnit dhe pajisjeve tjera komunale, sikurse janë paraparë nga autoriteti kontraktues pajtohet me konstatimet e ekspertit shqyrtues.

Duke ju referuar sërish pikës 9.1 & 9.2, pika 5, të DT, ankuesi ka pohuar se nga kuadri i kërkesave lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional, është kërkuar vërtetim i firmosur dhe vulosur nga prodhuesi i superstrukturës me numër të prokurimit dhe modelit të superstrukturës së ofruar, kurse GOE të rekomanduar (sipas ankuesit) nuk ka e saktësuar modelin e superstrukturës me të cilën ofertuar. Paneli vëren se eksperti shqyrtues e ka analizuar ofertën e GOE të rekomanduar për dhënie të kontratës edhe nga ky aspekt dhe ka dhënë mendimin se GOE të rekomanduar për dhënie të kontratës e plotëson këtë kërkesë të DT, sepse janë prezantuar dëshmitë vërtetimet të firmosura dhe të nënshkruara nga prodhuesi i superstrukturës të cilat janë veçuar si të tilla dhe nga ana e ekspertit. Paneli vëren se hulumtimet dhe analizat e ekspertit shqyrtues edhe në këtë rast duhen marrë në konsideratë meqë sipas shkresave të kësaj lënde, eksperti ka të drejtë.

Më tej, duke ju referuar po ashtu pikës 9.1 & 9.2 (paragrafi 8) të dosjes së tenderit, konstatohet se autoriteti kontraktues ka kërkuar 5/pesë saldator të punësuar nga prodhuesi, me certifikata të vlefshme për testimin e kualifikimit të saldatoreve sipas standardit EN ISO 9606-1 2017, ose standard kombëtar ekuivalent. Kurse GOE të propozuar për kontratë, ka ofruar certifikatat e kualifikimit të saldatorëve sipas standardit të kërkuar por asnjeri nga ata nuk e ka certifikatën e vlefshme. Në fakt, sikurse kuptohet edhe nga raporti i tij/saj ekspertit shqyrtues i prezantuar dhe analizuar një seri veprimesh shkresash e veprimesh të OE dhe autoritetit kontraktues nga faza e shqyrtimit fillestar e gjer tek procedura e rishqyrtimit dhe pa nevojë që çdo konstatim, hulumtim, analizë e këtij raporti të përshkruhet sërish në këtë rast,

ka konstatuar se certifikatat në rastin konkret nuk përmbajnë të meta dhe përkundër faktit se vet prodhuesi me deklaratë ka potencuar se te njëjtat certifikime janë konfidenciale, mund të gjenden si prove ne e-prokurim me efekte të vlefshmërisë sipas standardit.

Në vijim të pohimeve të tij/saj, Ankuesi ka atakuar Vendimin e cituar si më sipër në raport me pozicionin 13, te pikës 9.1 & 9.2 te fletës së dosjes së tenderit (FDT) sipas së cilës është kërkuar, katalog i shasisë, i nënshkruar dhe vulosur. Dhe ka pohuar se katalogu i dorëzuar nga GOE te rekomanduar për dhënie te kontratës ka ndryshime nga katalogët e prodhuesit te publikuar ne ueb-faqe, duke i shpjeguar ato me të ashtuquajturat pozicionet “Wheelbase” dhe “Technicaly permissible (shih shpjegimet në raport). Megjithëse, nga raporti i ekspertit shqyrtues, kuptohet se janë analizuar dhe krahasuar dimensionet e produktit “Ford TRUCKS 1833 DC Euro 6” dhe ka rezultuar se ne katalogun e publikuar ne ueb-faqen e prodhuesit dimensionet për te njëjtin produkt ndryshojnë nga katalogu i prezantuar ne oferte për te njëjtin produkt, mirëpo është shpjeguar po ashtu se autoriteti kontraktues ka kërkuar nga prodhuesi (datë 08.09.2023) konfirmim te katalogut dhe përmbajtjes se te njëjtit katalog ne kuptim te saktësi tije, për çfarë ku prodhuesi është deklaruar se te dhënat ne katalog janë te sakta.

- Ankuesi OE “VIBTIS” -

Ankuesi, ka pohuar se me vendimin e atakuar janë shkelur dispozitat e nenit 7, 59, 65 të LPP dhe neni 68 i Udhëzuesit për Prokurimin Publik lidhur me nenin 68 të LPP, duke shpjeguar se vendimi i AK për eliminimin e ofertës së tij për mos-plotësim të kërkesës së dosjes së tenderit (DT) përkitazi me kapacitetin teknik dhe profesional për kontrata të kësaj natyre ose të ngjashme me vlere minimale 2,000,000.00 € është pabazuar, sepse (sipas ankuesit) AK nuk ka treguar kujdes në vlerësimin në dokumentet e dorëzuara nuk është përfshirë dhe/ose llogaritur tatimi mbi vlerën e shtuar, meqë ky është rregull në procesin e prokurimit publik në Evropë dhe se sipas Direktivës 2014/24 ofertat në prokurim publik të dorëzohen pa e llogaritur apo përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar, përderisa sipas legjislacionit për prokurimin publik në Kosovë, kjo bëhet duke përfshirë dhe tatimin e cituar. Paneli vëren se gjatë rivlerësimit janë analizuar e tij/saj të gjitha këto pohime ankimore dhe provat e dorëzuara, mirëpo AK i ka konsideruar të pa bazuara dhe të njëjtat kanë qenë po ashtu dhe objekt i analizave nga ekspertit shqyrtues, sipas të cilit pohimi ankimor nga kjo pikëpamje është i bazuar dhe nuk kontestohet pohimi ankimor nëse për ndryshim nga Kosova, në Shqipëri dhe/ose vendet e BE-së dhe/ose sipas Direktivës së cituar në proceset e prokurimit nuk kërkohet përfshirja e tatimit të vlerës së shtuar, mirëpo njëherësh po sipas ankuesit nuk është kontestuese se kjo kërkesë buron nga legjislacioni në Kosovë, përkatësisht nga dispozitat e LPP, të cilat krijojnë efekte detyruese për çdo autoritet kontraktues.

Përkitazi me pohimet se GOE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar kërkesat e DT, ankuesi, njëherësh edhe eksperti shqyrtues ka deklaruar se makineritë e ofertuara nga GOE të rekomanduar për kontratë, si Otokar Atlas 8.5t -12t dhe Ford Truck 1833 DC 12, i takojnë dy prodhuesve të ndryshëm rrjedhimisht nuk është plotësuar kërkesa e kapacitetit teknik dhe profesional, andaj sipas ekspertit ky pretendim ankimor (sipas tij/saj) është i bazuar, sepse: a) GOE të rekomanduar për kontratë ka ofertuar me makineritë “Otokar Atlas 8.5t -12t” dhe “Ford Truck 1833 DC 12” dhe ka

dorëzuar Konfirmimin nga “Ford Central and Eastern Europe”; Autorizimin nga “Albania Motor Company” për anëtarin “D&T Group” ShPK; dhe Autorizimin nga “Otokar Otomotiv Ve Savunma Sanayi A.S”. Më tej: Ford Truck 1833 DC 12 është makineri e prodhuar nga Ford Otosan me seli në Turqi, me aksionar Ford Motor Company (41%) dhe Koç Holding A.S. (41%) si dhe aksione në tregtim (18%). Kurse Otokar Atlas 8.5t -12t është makineri e prodhuar nga “Otokar Otomotiv Ve Savunma Sanayi A.S” me aksionar Koç Holding A.S. (45%) Ünver Holding A.S. (25%) dhe të tjerë (30%). Dhe më tej: c) për makinerinë Otokar Atlas 8.5t -12t në katalog është vendosur shenja e prodhuesit “Ford” Kurse në katalogun e prodhuesit “Otokar Otomotiv Ve Savunma Sanayi A.S” nuk figuron kjo shenjë. Në kontekstin e pohimeve si më sipër, Ankuesi ka theksuar në vijim se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP duke rekomanduar GOE i cili ka dorëzuar katalog me të dhëna të pasakta dhe të cilat dallojnë nga të dhënat e prodhuesit. Megjithatë një deklarami i tillë dhe bazuar në një pohim (të njëanshëm) ankimor se Grupi i OE të rekomanduar se ka dorëzuar një dokument të rremë me të dhëna të manipuluar, nuk është provë për anulimin e një akti përfundimtar të një institucioni, deri sa i njëjti nuk vërtetohet tek institucionet kompetente dhe personat kompetent, kështu që për këtë AK në fazën e ri-vlerësimit të aplikojë nenin 59 dhe 72 të LPP, duke kërkuar sqarime shtesë si dhe si dhe në pajtim paragrafin 7 të nenit 52 të LPP-së, të kryej një kontroll efektiv për qartësimin e plotë lidhur me vërtetësinë e këtyre katalogjeve dhe vërtetësinë e pohimeve të ankuesit.

Ankuesi ka pohuar se “Kosova Motors JSC” si anëtar i GOE ka dorëzuar deklaratën nën betim jo e nënshkruar nga personi i autorizuar, sepse është nënshkruar nga Menaxheri i Shitjes, i cili nuk evidentohet në informata mbi biznesin person i autorizuar i kompanisë është N.H. Lidhur me këtë, thuhet “eksperti sqaron se në lidhje me Deklaratën nën betim, KRPP ka dhënë opinionin nr. 14, me 24.10.2023, lidhur me pyetjen: “A mund të nënshkruhen Deklarata nën betim dhe dokumentet tjera të Dosjes së Tenderit në emër të përfaqësuesit të Operatorit Ekonomik ofertues, nga një person i pa autorizuar”. Duke ju referuar interpretimit të KRPP, Paneli shpjegon se çështja e autorizimit nuk rregullohet me dispozita të LPP por me ligje tjera në fuqi dhe konsideron se autorizimi nuk karakterizohet me ndonjë të metë, i/e cila do ti mohonte efektet juridike të tij dhe i njëjti është dhënë nga titullari i një të drejtë, sipas të cilit i autorizuari ka të drejtë zbatojë një aktivitet, projekt apo të kryej veprime të caktuar, në pajtim me kushtet e përshkruara sikurse parashihet mes tjerash dhe me nenin 17 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative. Në të vërtetë nuk mund të kontestohen veprimet e përfaqësimi të një subjekti (juridik apo fizik) nga palë të treta nëse ato janë të pranueshme nga titullari i asaj të drejte, përfshirë dhe deklaratën në betim. Në të vërtetë, përmbajtja e autorizimit, respektivisht elementet qenësore, përfshirë sidomos vëllimin dhe efektet juridike të tij, rregullohen në mënyrë specifike me Ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve [LMD], me të cilin Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nuk përmban absolutisht asnjë normë kolizive. Sipas LMD autorizimi i referohet ekskluzivisht vullnetit të titullarit, duke e shpjeguar fare qartë se autorizimi për përfaqësim bazohet në ligj, në aktin e përgjithshëm të personit juridik, në aktin e organit kompetent ose në vullnetit e të përfaqësuarit. Prandaj, raporti i ekspertizës përmban një Pasqyrim real dhe objektiv për të gjitha aktet dhe veprimet e palëve në kontekstin efekteve juridike të tij, Paneli në këtë rast mbështet mendimin e tij/saj në raport me pikëpamjet e ekspertit shqyrtues. Ankuesi ka atakuar vendimin e AK dhe nga aspekti se OE “Haxhijaha” SHPK nuk i ka plotësuar kërkesat e DT, lidhur me

kapacitetin teknik dhe profesional. Mirëpo në këtë rast, Paneli veçoi pohimet e ankuesit lidhur me "Haxhijaha" SHPK, përderisa i njëjti nuk është kualifikuar për kontratë por është palë ankimore në këtë çështje e cila është njëherësh lëndë shqyrtimi.

- Përfundim -

Pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe administrimit me të gjitha provat në dispozicion të shkresave të kësaj lënde. Megjithatë në të dyja rastet, respektivisht dosjet ankimore, vërehet se të dy ankuesit e kanë atakuar në parim vendimin e AK, posaçërisht në vështrim të kërkesave të përshtatshmërisë, përfshirë: a) përshtatshmërinë profesionale; b) kapacitetin ekonomik dhe financiar; c) lidhur me dokumentet e kërkuara lidhur me këto kërkesa. Mirëpo duke i analizuar ankesat në rastin konkret, përfshirë dhe mendimet e ekspertëve shqyrtues, Paneli tërhoqi vëmendjen e tij lidhur me faktin se:

a) Sipas ankuesit "N.P.T. "Haxhijaha" SHPK, GOE të rekomanduar për kontratë, nuk ka e saktësuar modelin e superstrukturës me te cilën ofertuar [pa nevojë për ti përsëritur sërish nga ky aspekt pohimet ankimore] duke e atakuar posaçërisht Vendimin e AK në kontekstin e përputhshmërisë së katalogut, në vështrim të pikave 9.1 & 9.2 te FDT.

b) Po ashtu edhe ankuesi "Vibtis" dhe në Raportin e ekspertit shqyrtues përkitazi me këtë ankesë, pretendohet se GOE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar kërkesat e DT duke theksuar se makineritë e ofruara nga GOE të rekomanduar për kontratë, i takojnë dy prodhuesve të ndryshëm rrjedhimisht nuk është plotësuar kërkesa e kapacitetit teknik duke theksuar më tej se GOE i cili ka dorëzuar katalog me të dhëna të pasakta të cilat dallojnë nga të dhënat e prodhuesit.

Ndonëse nga pikëpamja e këtij Paneli, pohimet ankimore të veçuara si në pikat a) dhe b) nuk janë shoqëruar me prova jo kontestuese, megjithatë vendosi që çështja në rastin konkret ti nënshtrohet procesit të rivlerësimit nisur kryesisht nga synimi parimor që AK t'i verifikoj dhe një herë pohimet ankimore si më sipër, për hirë të informimit, transparencës, objektivitetit, shqyrtimit dhe vendosjes profesionale, në radhë të parë për hire të integritetit të procesit të prokurimit publik, i cili si i tillë gjithnjë kërkohet në kuptim të nenit 1 të LPP, pa e cenuar autonominë e plotë të AK në kuptim të planifikimit të prokurimit nevojave të tij/saj sikurse parashihet jo në kuptim të nenit 8 dhe 9 lidhur me nenin 52, 59 të LPP. Andaj veprimet e AK të cilat kërkohet që të ndërmerren në procesin e rivlerësimit në kuptim të neneve 52 dhe 72 të LPP, shtojnë sigurinë e një vendosje të drejtë, përderisa Paneli ka të drejtë që para marrjes së një vendimi përfundimtar, të kërkojë nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, sikurse parashihet kjo sipas neni 116, paragrafi 3, të LPP.

Andaj nga të lartcekurat, e duke vepruar në harmoni me kompetencat e parapara me nenin 98, 99 105 dhe 116 të LPP, paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimet të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - N. P.T. " Haxhijaha" Sh.p.k., " VIBTIS " DEGA NË KOSOVË**
- Arkivës së OSHP-së: